

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1305 Rep.
Nr. 251 Kol.

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 12.06.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje noter Ilir Qejvani, anëtar i Dhomës së Noterëve, me studio në Rr. "Myslym Shyri", Pall.44/1/2, u paraqitën personalisht dhe më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shitje Kuotash:

SHITESI: **Islam Rufo Veshi**, lindur me 08.09.1977 në Tiranë, banues në Tiranë, Rr."Xh. Delli", Pall.ABG, Ap.23, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letër Njoftimi ID Nr.H70908097Q; me cilësinë e Ortakut të shoqërisë "PATIO" Sh.p.k, regjistruar në organet tatimore me NIPT L81617033I.

BLERESI: **Armando Haki Skarra**, lindur me 07.1990 në Peshkopi, banues në Tiranë, ssh Fusha e Aviacionit, Rr. »S.Gjoni », Nd.28, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letër Njoftimi ID Nr.J00716078Q.

z. Islam Veshi është ortak i shoqërisë "PATIO" Sh.p.k me 50 % të kapitalit të shoqërisë, zotërues i 1 kuote, e barabartë me 100 (njëqind) lekë.

Në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie mbajtur në datën 31.05.2019 është vendosur largimi nga shoqëria i ortakut Islam Veshi dhe shitja e të gjitha kuotave që ai zotëron, pra 1 (kuotë), e barabartë me 100 (njëqind lekë) lekë, tek ortaku tjetër i shoqërisë z. Armando Skarra, i cili po dhe ky është ortak i kësaj shoqërie me pjesë të barabarta.

Edhe blerësi Armando Skarra është dakort të blejë kuotat e ortakut Islam Veshi dhe të mbetet ortak i vetëm i shoqërisë "PATIO" Sh.p.k me pjesë të plota.

Çmimi i shitjes së këtyre kuotave është 100 (njëqind) lekë, i cili është likujduar jashtë kësaj zyre nga blerësi dhe palët nuk kanë asnjë pretendim.

Përfundimisht me blerjen e këtyre kuotave z. Armando Skarra bëhet Ortak i Vetëm i shoqërisë "PATIO" Sh.p.k me 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse humbet të drejtën e kuotave me përqindjet përkatëse që shet, ndërsa pala blerëse bëhet pronare e tyre.

Shitësi xhivshet nga çdolloj detyrimi financiar për të tretët dhe ndaj shtetit.

Kjo kontratë shitje përpilohet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "PATIO" Sh.p.k.

Kontrata e shitjes së kuotave e datës 31.05.2019 me Nr.1231 Rep, e Nr.234 Kol quhet e zgjidhur. Kontrata u përpilua në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore, iu lexua palëve kontraktuese me zë të lartë, u kuptua prej tyre dhe meqënëse shpreh vulnetin e tyre të plotë e të lirë u nënshkrua rregullisht prej tyre para meje dhe unë noter i vërtetoj ato sipas ligjit.

SHITESI

ISLAM VESHI

BLERESI

Armando Skarra

NOTERI

Ilir Qejvani

